



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM /
MINISTARSTVO ZA ZAJEDNICE I POVRATAK / MINISTRY OF COMMUNITIES AND RETURN

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE **KTHIM**

Termat e References (Proceduart Standarde të Operimit)

Përbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTESAT	4
I. HYRJE (MBI KËTO TERMA TË REFERENCAVE)	5
II. SFOND (MBI FORMIMIN E ZKKK-VE)	5
III. TË DREJTAT E KOMUNITETEVE DHE QASJA NË SHËRBIME	9
1. Sfond	9
2. Palët me interes dhe partnerët	10
3. Aktivitetet/Procedurat	11
3.1. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë e përfituesve (kush? çka? si?)	11
3.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara (kush? çka? si?)	12
3.3. Vlerësimi i nevojave të përfituesve (kush? çka? si?)	12
3.4. Zhvillimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi (kush? çka? si?)	13
3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivelin komunal (kush? çka? si?)	13
3.6. Dhënia e këshillave për ekzekutivin komunal dhe organet përfaqësuese (kush? çka? si?)	14
3.7. Raportimi (kush? çka? si?)	15
3.8. Vetëdija publike (kush? Çka? si?)	15
3.9. Planifikimi dhe buxheti i zyrës (kush? çka? si?)	16
3.10. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave të përfituesve (kush? çka? si?)	16
III. KTHIMI	17
1. Sfondi	17
2. Palët e interesuara dhe partnerët	19
3. Aktivitetet /Procedurat	19
3.1. Zhvillimi dhe mbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë përfituese (kush?, çfarë?, si?)	19
3.4. Zhvillimi i projektit,monitorimi dhe vlerësimi (Kush? Çka? Si?)	23
3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivel komunal (Kush? Çka? Si?)	24
3.6. Ofrimi i këshillave për organet komunale ekzekutive dhe përfaqësuese (Kush? çka? si?)	25
3.7. Raportimi (Kush? Çka? Si?)	25
3.9. Planifikimi dhe Buxheti i Zyrës (Kush? Çka? Si?)	27
3.10. Mirëmbajtja e bazës të të dhënave të përfitueseve (kush ? çfarë? si?)	27
IV. RIATDHESIMI	29

1. Sfondi	29
2. Palët e interesuara dhe partnerët	31
3. Aktivitetet/Procedurat	32
3.1. Zhvillimi dhe mbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë përfituese (kush?, çfarë?, si?).....	32
3.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara (kush?, çfarë?, si?).....	32
3.4. Zhvillimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi (Kush? Çka? Si?).....	34
3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivel komunal (Kush? Çka? Si?).....	37
3.6. Ofrimi i këshillave për organet komunale ekzekutive dhe përfaqësuese (kush? çka? si?)	37
3.7. Raportimi (Kush? Çka? Si?)	38
3.8. Vetëdijesimi Publik (Kush? Çka? Si?).....	38
3.9. Planifikimi dhe Buxheti i Zyrës (Kush? Çka? Si?).....	39
3.10. Mirëmbajtja e bazës të të dhënave të përfitueseve (kush ? çfarë? si?).....	39
ANEKSET	40

Akronimet dhe Shkurtesat

Caritas: Caritasi Nderkombetare

GPK (MWG): Grupa Punuese Komunale per Kthim

KKK: Keshilli Konsultativ per Komunitete i themeluar nen kujdesin e Presidentit te Republikes se Kosoves.

KDIK: Komiteti per te Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve I Kuvendit te Kosoves

KDR (DRC): Keshilli Danez per Refugjate

MKK: Ministria per Komunitete dhe kthim

MASHT: Ministria e Arsimit, Shkences dhe Teknologjise

MAPL: Ministrai e Administrimit te Pushtetit Lokal

MPMS: Ministria e Punes dhe Mireqenjes Sociale

MSH: Ministria e Shendetesise

MPB: Ministria e Puneve te Brendshme

MAP: Ministria e Administrates Publike

NjMKK/ZKM: Njesiti per Mbeshtetje te Kthimit dhe Koordinimit prane Zyres se Kreministrit ON (IOs): Organizatat Nderkombetare OJQ (NGO): Organizatat Jo-qeveritare

OSBE: Organizata per Siguri dhe Bashkepunim ne Evrope, Misioni ne Kosove PK

(KP): Policia e Kosoves PSO (SoP): Procedurat Standarde te Operimit

ToR: Termet e Referiumit

TF: Task Force

UNMIK: Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

UNDP: Programi per Zhvillim I Kombeve te Bashkuara

UNHCR: Komesariati I Larte I Kombeve te Bashkuara per Refugjate ZCN (ICO): Zyra Civile Nderkombetare

ZCK/ZKM: Zyra per Ceshtje te Komuniteteve prane Zyres se Kryeministrit ZLK (MCO): (ish) Zyrat Lokale/Komunale per Komunitete ZKK (MRO): (ish) Zyrtaret Komunale per Kthim

ZKKK: Zyra Komunale per Komunitete dhe Kthim ZNKE (ECLO): Zyra Nderlidhese e Komisionit Evropian

ZKQDK: Zyra Keshilluese per Qeverisje te mire dhe per te Drejtat e Komunitetve prane Zyres se Kryeministrit

I. Hyrje (mbi këto Termta të Referencave)

Cilat janë këto Termta të Referencës? Pse TeR (Qëllimi)? Për kë janë këto TeR? Se si të përdoren TeR

Këto Termta të Referencës – Procedurat Standarde Operative (TeR-PSO) ndihmojnë komunitat në zbatimin e Rregullores së Qeverisë Nr. 02/2010 për Zyrrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK).

Termtat e Referencës-PSO kanë adresuar fushat kryesore të veprimtarisë të ZKKK-së: Të drejtat e komuniteteve dhe qasja në shërbimet publike; kthimi; riatdhesimi duhet të përdoret në lidhje me përshkrimin relevant të punës.

Ministria për Komunitetet dhe Kthim dhe institucionet tjera relevante të pushtetit qendror duhet të sigurojnë që stafi i ZKKK-ës të marr trajnime adekuate dhe të kenë qasje dhe mundësi të mjaftueshme për zhvillim profesional bazuar në nevojat e tyre për ngritjen e kapaciteteve.

II. Sfond (mbi formimin e ZKKK-ve)

Korniza institucionale dhe politike

Kosova është një shoqëri multi etnike në të cilën jetojnë komunitetet të ndryshme jo-shumicë (nacionale, etnike, kulturore, grupet gjuhësore jo-shumicë tradicionalisht të pranishme në territorin e saj) siç janë Serbët, Turqit, Boshnjakët, Romët, Ashkalit, Egjiptasit, Gorant, Malazezët, Kroatët, dhe të tjerët. Shumica Shqiptare njihet edhe si komunitet jo-shumicë në komuna të veçanta.

Për shkak të ngjarjeve dhe rrethanave që kanë ndodhur gjatë dekadave të fundit në historinë e saj, duke përfshirë edhe konfliktin e armatosur të vitit 1999, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë së Kosovës ka përjetuar dhe vazhdon të përjetoj migrimin dhe zhvendosjen. Në të njëjtën kohë, është në rritje numri i emigrantëve apo përfituesve të statutit të azilit, vendbanimi i të cilëve apo statusi i azilit është duke ju përfunduar në vendet e Evropës perëndimore, janë dhe mund të jenë në të ardhmen subjekt i masave për riatdhesimin e tyre në Kosovë. Refugjatëve, personave të zhvendosur, dhe personave të riatdhesuar që kanë të drejtë të përfitojnë prej krijimit të kushteve të qëndrueshme, kthim të sigurt dhe ri-integrim.

Republika e Kosovës është angazhuar që të garantoj barazinë dhe pjesëmarrjen e gjithë individëve dhe komuniteteve. Ajo është angazhuar për të siguruar kthim të sigurt dhe të dinjitetshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur dhe u ndihmon atyre për kthimin e pronave të tyre dhe të pasurisë.

Kushtetuta, Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve në Kosovë, Ligji mbi përdorimin e gjuhëve, mbështetja e legjislacionit për vetëqeverisje lokale dhe decentralizim, legjislacione tjera dhe politika që njohin të

drejtat e komunitetit jo-shumicë. Ata gjithashtu ofrojnë mekanizma të veçantë institucional për mbrojtjen dhe promovimin e këtyre të drejtave dhe kërkojnë miratimin e masave të posaçme për të siguruar pjesëmarrje efektive në jetën publike duke u bazuar në barazi për të gjithë.

Politikat specifike promovojnë kthimin dhe ri-integrimin e refugjateve dhe personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar nga vendet e treta, dhe komuniteteve të pambrojtura.

Institucionet e veçanta rezervojnë vende të veçanta për komunitetet jo-shumicë në Kuvendin e Kosovës; Poste të Ministrive për përfaqësuesit e komuniteteve jo-shumicë; Komuniteti për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për Kthim në Kuvendin e Kosovës; Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK); Këshilli Konsultativ për Komunitete nën Zyrën e Presidentit; Komisioni i Gjuhëve; Zyra për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit për (ZÇK), Njësia për Koordinim Mbështetje dhe Kthim(NKMK); Qeverisja e Mirë dhe të Drejtat e Njeriut (QMDN)Njësia Ministrore për të Drejtat e Njeriut.

Ministritë tjera kanë një rol veçanërisht të rëndësishëm në fushat e politikës me interes për komunitetet, refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e riatdhesuar në Kosovë. Këtu përfshihen: Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Legjislacioni për Qeverisje Lokale ka udhëhequr decentralizimin në Kosovë dhe ka themeluar mekanizma të ri institucional për pjesëmarrjen e komuniteteve jo-shumicë në nivelin lokal: Zëvendës kryetarët dhe Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete; Komisionet e Kuvendi të Komunës për Komunitete; Njësia për të Drejtat e Njeriut.

Që nga Gushti i vitit 2010, Zyrrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) paraqesin një mekanizëm të ri institucional të domosdoshëm për promovimin e drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim në nivel komunal.

Pse u formuan ZKKK-të dhe cili është mandati i tyre

Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacionin ofrojnë të drejta specifike për komunitetet jo-shumicë në çështjet e identitetit, barazi, gjuhë, kulturë, media, religjion, edukim, mundësive ekonomike dhe sociale, dhe qasje në shërbime publike dhe pjesëmarrje në jetën publike.

Kushtetuta kërkon që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të krijojnë kushte të përshtatshëm që të ju mundësojnë komuniteteve që ti gëzojnë këto të drejta. Ajo kërkon që të gjitha institucionet e Republikës të krijojnë kushte për kthim të qëndrueshëm, kthim të sigurt dhe të dinjitetshëm dhe ri-integrim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur.

Si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale, komunat janë përgjegjëse, për të promovuar dhe për të mbrojtur të drejtat e komuniteteve jo-shumicë dhe për tu siguruar se këto

komunitete kanë qasje të barabartë në shërbimet publike dhe të kenë mundësi për të marr pjesë në marrjen e vendimeve komunale. Komunitetet janë përgjegjëse për kontributin e mëtutjeshëm, në bashkëpunim me institucionet e nivelit qendror, për krijimin e kushteve për refugjat, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar ku mund të kthehen dhe të gëzojnë shërbimet adekuate publike dhe mundësin e ri-integrimit.

Rregullorja e Qeverisë 02/2010 kërkon që të gjitha komunitetet të krijojnë struktura adekuate administrative, Zyrrat Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, qasje të barabartë të komuniteteve në shërbimet publike, dhe krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar. Themelimi i ZKKK iu përgjigjet obligimeve të marruar të Republikës së Kosovës që të promovoj dhe të mbroj të drejtat e njeriut (Kapitulli II i Kushtetutës), të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (Kapitulli III i Kushtetutës) krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur (Neni 156 i Kushtetutës).

ZKKK-ja ndihmon zyrrat komunale në mënyrë të duhur që të mbrojnë të drejtat e komuniteteve dhe të ofrojnë shërbime publike për gjitha komunitetet, duke përfshirë refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat që mund të ri pranohen në Kosovë pas riatdhesimit të tyre. Ajo këshillon Kryetarin, drejtoritë komunale, kuvendin komunal dhe disa institucione të veçanta të komunës që kanë të bëjnë me punët e komuniteteve. Nëpërmjet kësaj këshille ZKKK synon të sigurojë që vendimet e komunës, politikat dhe shërbimet janë të bazuara me një pjesëmarrje efektive të komuniteteve, në mënyrë adekuate për t'iu përgjigjur situatave specifike, nevojave dhe drejtave të komuniteteve jo-shumicë dhe t'ju mundësoj komuniteteve të gëzojnë barazi.

Para themelimit të Zyrrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, gjatë periodës së Misionit të Kombeve të Bashkuara të Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK, Qershor 1999-2008), Zyrrat Komunale për Komunitete (ZKK) dhe Zyrrarët Komunal për Kthim (ZKK) janë prezentë në shumicën komunave në të cilat jetojnë komunitetet jo-shumicë. Mandati i tyre ishte i rregulluar me Rregulloren nr 2000/45 të UNMIK-ut dhe nr 2007/30 mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë.

ZKKK zëvendëson ZKP-të dhe ish zyrraret komunal për kthim ZKK dhe mundëson një zbatim më të qëndrueshëm të politikave në fushën e drejtave për komunitete, qasje të barabartë të komuniteteve në shërbime publike; kthimi dhe ri-integrimi në komuna . Ai është përgjegjës për të siguruar që politikat e tilla zbatohen në koordinim të plotë me institucionet përkatëse komunale dhe me institucionet qendrore qeveritare.

Komunitetet duhet të sigurojnë që ZKKK përfshin dhe kryen në minimum , funksionet e mëposhtme:

1. Shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim;
2. Koordinator për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrim;
3. Zyrtari(ët) për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrim;
4. Koordinator për kthim të qëndrueshëm;
5. Zyrtari(ët) për kthim të qëndrueshëm.

Bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara në Nenin 6 të Rregullores, funksionet e zyrës mund të kryhen edhe nga një numri i vogël i pozitive (zyrtarëve) me funksione të kombinuara, ose me numër më të madh të pozitive (zyrtarëve) sipas funksionit. Përshkrimet e punës për këto funksione kanë qenë të përgatitura nga një grup punues ndër-ministrior, dhe të udhëhequr nga Ministria për Komunitete dhe Kthim.

III. Të drejtat e komuniteteve dhe qasja në shërbime

1. Sfond

Për cilat probleme/çështje/nevoja duhet të përgjigjet zyra

ZKKK themelohet për të –

- Siguruar që politikat e qeverisë për komunitetet jo-shumicë të zbatohen në mënyrë të koordinuar dhe konsistente në të gjitha komunat
- Siguruar që të gjitha komunat kanë krijuar struktura të përshtatshme administrative për të koordinuar zbatimin e politikave të lidhura me të drejtat e komuniteteve, qasjen e komuniteteve në shërbime
- Rritur kapacitetin e autoriteteve komunale për të arritur komunitetet jo-shumicë dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre
- Rritur konsultimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve jo-shumicë për politikat dhe vendimet komunale

ZKKK (Shefi i Zyrës, Koordinatori dhe Zyrtari/ët për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrimin) do të ndihmojnë institucionet komunale dhe ofruesit tjerë të shërbimeve publike në komunë për të –

- Konsultuar dhe përfshirë komunitetet jo-shumicë në vendimet dhe politikat e tyre
- Vlerësuar nevojat e komuniteteve jo-shumicë
- Mbrojtur të drejtat e komuniteteve nëpërmjet vendimeve/politikave të tyre
- Siguruar qasje të barabartë në shërbimet publike nga të gjitha komunitetet

Për këtë qëllim ZKKK (Shefi i Zyrës, Koordinatori dhe Zyrtari/ët për të Drejtat e Komuniteteve dhe Integrimin) do të

- Bashkëpunojë me palët e shoqërisë civile dhe institucionale në nivel komunal dhe qendror;
- Kontaktojë të gjitha komunitetet jo-shumicë që jetojnë në komunë, për të vlerësuar nevojat e tyre dhe për prioritizimin e masave për trajtimin e tyre;
- Sigurojë mundësitë për komunitetet për të marrë pjesë në zhvillimin e strategjive dhe politikave për të adresuar nevojat e tyre. Kjo përfshin të mundësuarit e komuniteteve që të shprehin nevojat e tyre, që ato të përfshihen në veprimet/planet përgjegjëse, dhe për pjesëmarrjen në zbatimin e veprimeve/planeve të tilla;
- Zhvillojë, zbatojë, monitorojë dhe vlerësojë projektet e lidhura me të drejtat e komuniteteve dhe të qasjes së komunitetit në shërbimet publike;
- Monitorojë zbatimin e politikave komunale;

- Ofrojë këshilla organeve të komunës e degës ekzekutive dhe legislative dhe kjo do të përfshijë:
 - Identifikimin dhe prioritizimin e të drejtave të komuniteteve dhe rekomandimin e masave konkrete për promovimin/mbrojtjen e tyre;
 - Identifikimin se cilat shërbime duhet të sigurohen për komunitetet e ndryshme dhe rekomandimin e masave konkrete për sigurimin e tyre;
 - Funkcionimin e mekanizmave për marrjen, përpunimin dhe trajtimin e ankesave nga komunitetet;
- Raportojë mbi rezultatet e monitorimit, këshillat e dhëna, dhe projektet e zbatuara;
- Mirëmbajë një bazë të dhënash për komunitetet jo-shumicë;
- Zhvillojë aktivitete për ndërgjegjësimin e publikut.

2. Palet me interes dhe partnerët

Kush janë palët e interesuara të përfshira në zbatimin e këtyre TeR-ve (institucionet komunale dhe qendrore, OI-të, OJQ-të) dhe cilat janë marrëdhëniet ndërmjet tyre

Në nivel komunal Zyra komunale për komunitete dhe kthim do të bashkëpunojë me -

- *Institucionet komunale:* Kryetarin dhe drejtoritë e degës së ekzekutivit, kompanitë publike, institucionet dhe zyrat për ofrimin e shërbimeve publike (të tilla si qendra për punë sociale; qendrat e shëndetit familjar, zyrat e gjendjes civile dhe regjistrimit civil, qendrat rajonale për punësim, shërbimet publike etj); kuvendi i komunës dhe komisionet e tij; mekanizmat e punëve të komunitetit (zëvendës kryetari komunal për komunitete; zëvendës kryetari i Kuvendit Komunal për Komunitete; komisioni i komuniteteve i Kuvendit Komunal); mekanizmat e të drejtave të njeriut (njësia për të drejtat e njeriut); përfaqësuesit e institucioneve të ZKKK-ve tjera, komunat dhe zyrtarët për barazi gjinore.
- *Palët tjera të interesuara:* Individët që i përkasin komuniteteve jo-shumicë dhe shumicë, OJQ-ve dhe partive politike që përfaqësojnë interesin e komuniteteve shumicë dhe jo-shumicë, organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që veprojnë në komunë.

ZKKK do të bashkëpunojë afër edhe me institucionet qendrore duke përfshirë -

- *Degën ekzekutive:* Zyra për Çështje të Komuniteteve në Zyrën e Kryeministrit, ministritë e linjës, të tilla si Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administratës

Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve

- *Dega legislative*: Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthimit;
- *Zyra e Presidentit*: Këshilli Konsultativ për Komunitete;
- *Institucionet e pavarura*: (Ombudspersoni, Agjencia për Barazi Gjinore, komisioni i Gjuhëve etj)

ZKKK duhet në veçanti të sigurojë që komunitetet janë të përfshira në procesin e zhvillimit të politikave dhe në zbatimin e tyre.

Brenda ZKKK, njësitë për të drejtat e komuniteteve dhe integrim, dhe kthim të qëndrueshëm do të bashkëpunojnë ngushtë për të siguruar përfshirjen dhe pjesëmarrjen e personave të zhvendosur në komunë.

3. Aktivitetet/Procedurat

3.1. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë e përfituesve (kush? çka? si?)

ZKKK (*Koordinatori dhe zyrtari/ët për të drejta të komuniteteve dhe integrim*) do të –

- Kryejnë vizita në teren, së paku një herë në muaj, te çdo komunitet jo-shumicë (në të gjitha lokacionet) dhe personat e zhvendosur në komunë;
- Organizojnë takime një herë në tre muaj me udhëheqësit dhe organizatat e komuniteteve të ndryshme jo-shumicë, dhe personat e zhvendosur në komunë;
- Mbjë lidhje me drejtoritë relevante komunale, nivelin qendror dhe lokal, dhe institucionet ndërkombëtare për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në aktivitetet e mësipërme të mbajtjes së kontaktit;
- Krijojë hartën e komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në kuadër të komunës: shih bazën e të dhënave;
- Prodhon dhe publikon dhe shpërndajë fletëpalosjet dhe materialet informuese duke përfshirë përgjegjësitë e ZKKK-së në lidhje me të drejtat e komunitetit dhe informatat e kontaktit të ZKKK të tilla si vendndodhja e zyrave të MKKK, orari i punës, detajet e kontaktit të personelit;
- Përdorë mediet lokale, duke përfshirë radio e TV dhe mediet e shkruara, për të shpërndarë informacion për komunitetet jo-shumicë në gjuhën e tyre;
- Krijojë mekanizma dhe procedura për t'u mundësuar komuniteteve që të kenë qasje të lehtë dhe të thjeshtë në ZKKK, duke bërë të mundur që ZKKK të trajtojë edhe situata dhe nevoja urgjente.

3.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara (kush? çka? si?)

ZKKK (Shefi i zyrës dhe nëse kërkohet, edhe Koordinatori për të drejta të komuniteteve dhe integrim) do të –

- Marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit të Drejtorëve dhe të Komisionit për Komunitete të Kuvendit Komunal, dhe raportojë mbi gjendjen e komuniteteve në komunë dhe punën e ZKKK;
- Sipas nevojës, të marrë pjesë në mbledhjet përkatëse të kuvendit të komunës dhe të komisioneve të tij;
- Marrë pjesë në takime të tjera relevante komunale (duke përfshirë edhe Këshillin Komunal për Siguri të Komuniteteve, debate publike dhe konsultime, debate dhe dëgjime buxhetore, etj);
- Organizojë çdo tre muaj (katër herë në vit), takime të palëve të interesuara dhe të mbajë kontakte të rregullta me këto palë të interesuara, duke përfshirë: Kryetarin, Zëvendës Kryetarin për Komunitete, zëvendës kryesuesin e kuvendit të komunës për komunitete, Kryetarin e Komisionit të Komuniteteve, drejtoritë relevante komunale, Zyrën e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve, MKK, MAPL, dhe organizatat ndërkombëtare;
- Organizojë rregullisht dhe ad hoc takime me zyrtarët relevantë komunalë;
- Hartojë planin e organizatave vendore dhe ndërkombëtare dhe OJQ-ve që punojnë në punët e komunitetit;
- Marrë udhëheqjen në organizimin e takimeve komunale për komunitetet jo-shumicë dhe personat e zhvendosur në komunë.

3.3. Vlerësimi i nevojave të përfituesve (kush? çka? si?)

ZKKK (Koordinatori dhe zyrtari/ët për të drejta të komuniteteve dhe integrim do të:

- Kryejë vlerësimin e nevojave në komunitetet jo-shumicë dhe personave të zhvendosur në komunë të paktën çdo gjashtë muaj;
- Krijojë mekanizma dhe procedura që u mundësojnë komuniteteve dhe personave të zhvendosur në komunë qasje të lehtë te ZKKK dhe përcjellin nevojat e tyre, veçanërisht në qoftë se lindin nevoja/situata specifike dhe të papritura;
- Shpërndajë rezultatet e vlerësimit të nevojave të komunitetit për të gjitha palët e interesuara dhe publikun;
- Identifikojë, bazuar në rezultatet e vlerësimit të nevojave, prioritetet dhe objektivat e përcaktuara vjetore dhe standardet, dhe i integron ato në planin vjetor të punës së ZKK;
- Paraqesë prioritetet dhe kërkojë integrimin e tyre në kuadër të planit komunal vjetor të punës

3.4. Zhvillimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi (kush? çka? si?)

Kryesuesi i ZKKK duhet të -

- Konsultohet me Komisionin e Komuniteteve të Kuvendit Komunal në përzgjedhjen e projekteve prioritare për komunitetet jo-shumicë;
- Marrë pjesë në përgatitjen e buxhetit të komunës dhe të paraqesë projekt propozimet prioritare për komunitetet jo-shumicë te kryetari dhe drejtori i financave dhe ekonomisë;
- Raportoje rregullisht te kryetari i komunës, Komisioni për Komunitete i Kuvendit Komunal dhe, nëse kërkohet, te institucionet e nivelit qendror, për zbatimin e projekteve për komunitetet

Koordinatori dhe zyrtarët për të drejta të komuniteteve dhe integrim duhet të -

- Organizojë konsultime publike në zonat e banuara nga komunitetet jo-shumicë dhe personat e zhvendosur në komunë për të identifikuar projektet prioritare që i prekin komunitetet e tilla dhe për t'i përfshirë ato projekte në buxhetin e komunës;
- Të sigurojë që çdo projekt synon arritjen e objektivave konkrete, të matshme, të arritshme dhe, që rreziqet të identifikohen siç duhet, dhe që objektivat të jenë në përputhje me planin e punës së ZKKK dhe nevojat e komuniteteve;
- Monitorojë dhe vlerësojë zbatimin e projekteve që kanë ndikim te komunitetet jo-shumicë sa i përket arritjes së këtyre objektivave, të korrigojë planin e zbatimit nëse është e nevojshme;
- Sigurojë mundësi për komunitetet për të marrë pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të projekteve ku ata janë përfitues;
- Bazuar në vlerësimin e projekteve, të identifikojë praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra dhe të zhvillojë projekte përkatëse në vazhdimësi;
- Mbajë nivelin e vetëdijesimit të donatorëve ekzistues dhe të bëjë propozime të hapura për komunat;
- Mbajë nivelin e vetëdijesimit për iniciativat e OJQ-ve lokale dhe të zhvillojë qasje të përbashkëta;
- Bazuar në prioritetet, të zhvillojë projekt propozime dhe t'i paraqesë ato tek institucionet përkatëse dhe donatorët;
- Rregullisht të bëjë koordinimin me palët tjera të interesuara (institucionet e nivelit qendror, organizatat ndërkombëtare) për aktivitetet dhe projektet në komunë.

3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivelin komunal (kush? çka? si?)

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim është përgjegjëse për të vlerësuar zbatimin e politikave për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komunitetit (duke përfshirë por jo vetëm Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe

Pjesëtarëve të tyre në Kosovë) dhe qasjen e barabartë të komuniteteve në shërbimet publike.

Një model raportimi i hartuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim është e bashkangjitur me këto Terma të Referencës.

Shefi i Zyrës së do të ofrojë udhëzime të mëtejshme dhe udhëzime për procedurat e monitorimit për koordinatorin dhe zyrtarin/ët për të drejtat e komuniteteve dhe integrimin.

Nën drejtimin e koordinatorit, zyrtari/ët për të drejtat e komuniteteve dhe integrimin do të-

- Monitorojë dhe vlerësojë ndikimin e politikave komunale për komunitetet jo-shumicë;
- Krijojë mekanizmat nëpërmjet të cilave komunitetet mund të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave komunale për të drejtat e tyre dhe qasjen në shërbime.

Vlerësimet e përfshira në raportet e ZKKK do të bazohen në -

- Reagimet nga përfituesit;
- Diskutimet dhe koordinimin me institucionet komunale dhe palët e interesuara;
- Monitorimin dhe përcjelljen e aktiviteteve për zbatimin e politikave komunale dhe ndikimin e tyre në të drejtat e komuniteteve dhe qasjen e tyre në shërbimet publike.

3.6. Dhënia e këshillave për ekzekutivin komunal dhe organet përfaqësuese (kush? çka? si?)

Për të siguruar që politikat komunale janë në përputhje me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit dhe qasje të barabartë të të gjitha komuniteteve në shërbimet publike, shefi i ZKKK do të:

- Në koordinim me institucionet e tjera të çështjeve të komuniteteve në komunë, të këshillojë institucionet komunale lidhur me marrëveshjet për pjesëmarrje efektive të komuniteteve jo-shumicë në proceset e vendimmarrjes;
- Informojë dhe konsultojë me komunitetet jo-shumicë për politikat komunale dhe të përcjellë nevojat e tyre, pikëpamjet dhe rekomandimet te institucionet komunale;
- Formulojë dhe diskutojë rekomandimet me kryetarin, Kuvendin Komunal dhe komisionet e tij, dhe Drejtoritë Komunale;

- Të propozojë veprime korigjuese institucioneve relevante komunale në rast të shkeljes.

Rekomandimet e ZKKK do të bazohen në konsultimet e rregullta me komunitetet jo-shumicë, si dhe vlerësimin e nevojave të tyre, të kryer nga zyrtarët e ZKKK-së.

3.7. Raportimi (kush? çka? si?)

Brenda ZKKK, zyrtarët raportojnë në baza javore te koordinatori për të drejtat e komuniteteve dhe integrimin. Koordinator i raporton shefit të zyrës.

Shefi i ZKKK i dorëzon raporte Kryetarit, Kuvendit të Komunës dhe komisioneve të tij në baza javore, mujore, vjetore dhe dyvjeçare në lidhje me punën e zyrës dhe situatën e komuniteteve.

Raportet vjetore dhe dyvjeçare duhet të publikohen dhe shpërndahen për komunitetet për komentet e tyre. Komentet e marra nga komunitetet dhe publiku i gjerë do të përfshihen në raportet e ardhshme.

Një model raportimi hartuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim është e bashkangjitur me këto Terma të Referencës.

Një kopje e raporteve të ZKKK do të dërgohet në institucionet përkatëse të nivelit qendror, duke përfshirë Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Zyrën e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve dhe Këshillin Konsultativ për Komunitete.

3.8. Vetëdija publike (kush? Çka? si?)

Brenda ZKKK, koordinatori dhe zyrtari/ët për të drejtat e komuniteteve dhe integrim do të organizojnë fushata të ndërgjegjësimit publik për të informuar personat e zhvendosur brenda komunës, komunitetet jo-shumicë, dhe publikun në përgjithësi lidhur me legjislacionin dhe politikat mbi të drejtat e komuniteteve dhe shërbimet publike. ZKKK do të shpërndajë për publikun edhe raportet dhe lajmet mbi aktivitetet dhe arritjet e saj.

Fushata do të zhvillohet në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë dhe do të përdoren mediet lokale, duke përfshirë shtypin, radio dhe TV si dhe faqen e internetit të komunës.

Fushata duhet të sigurojë që të arrijë deri te komunitetet.

3.9. Planifikimi dhe buxheti i zyrës (kush? çka? si?)

Koordinatori dhe zyrtari/ët për të drejta të komuniteteve dhe integrim do t'i ndihmojë shefit të zyrës për të siguruar:

- Zhvillimin e një buxheti vjetor të ZKKK (duke iu referuar veçanërisht të drejtave të komuniteteve dhe projekteve dhe aktiviteteve të integritit);
- Zhvillimin dhe zbatimin e një strategjie 3 vjeçare të ZKKK;
- Përgatitjen e planit vjetor të punës; dhe

Përgatitjen e planeve individuale të punës.

3.10. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave të përfituesve (kush? çka? si?)

Ministria e komuniteteve dhe kthimit, ministria e punëve të brendshme dhe ministria e punës dhe mirëqenies sociale do të-

- Zhvillojë një bazë të dhënash në të cilën ZKKK-të do të përfshijnë të dhëna mbi komunitetet jo-shumicë, refugjatët, personat e zhvendosur në komunë, dhe personat e riatdhesuar nën kujdesin e tyre.
- Trajtojnë personelin e ZKKK për të punuar me bazën e të dhënave dhe për mbrojtjen e të dhënave.

Nën mbikëqyrjen e Koordinatorit, zyrtari/ët për të drejta të komuniteteve dhe integrim do të -

- Përgatisë pyetësorët, kryejë intervista individuale, vlerësimet e komunitetit të gjerë dhe anketa dhe të përdorë mjete të tjera të zhvilluara në bashkëpunim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale për qëllimet e bazës së të dhënave të ZKKK;
- Rregullisht të përditësojë informacionin mbi komunitetet jo-shumicë në bazën e të dhënave të ZKKK;
- Të sigurohet se informacioni i bazës së të dhënave të ZKKK që mblidhen dhe përpunohen t'i nënshtrohet pëlqimit personal të individit të cilit i përkasin të dhënat personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

III. Kthimi

1. Sfondi

Cilat probleme/çështje/ nevoja u përgjigjet zyra

ZKKK-ja është krijuar për të ndihmuar Komunitetet në përmbushjen e objektivave të rëndësishme politike që lidhen me kthimin dhe ri-integrimin e refugjateve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar duke përfshirë -

- Mbrojtja dhe promovimi i drejtave të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar që kthehen, ose mund të kthehen në të ardhmen në komunë
- Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar, duke përfshirë dialogun në mes të të kthyerve dhe komuniteteve, Sigurinë dhe lirin e lëvizjes, pronës dhe strehimit, punësimit dhe mundësive ekonomike, arsimimit, dhe qasje të barabartë dhe adekuate në shërbimet publike
- Krijimi i koordinimit dhe bashkëpunimit tek organet komunale në zbatimin e politikave qendrore në lidhje me kthimin dhe ri-integrimin

ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari(ët) (e) për kthim të qëndrueshëm) do të ndihmojnë - asistojnë institucioneve komunale dhe ofruesve tjerë të shërbimeve publike në komunë për -

- Konsultime, përfshirjen e refugjatëve, personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar në vendimet e tyre dhe politikave
- Vlerësimi i nevojave të refugjatëve, personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar
- Mbrojtja e drejtave të refugjatëve, personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar nëpërmjet vendimeve të tyre / politikave
- Krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm, të sigurt dhe të dinjitetshëm dhe ri-integrim të refugjateve dhe personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar në komunë për t'ju siguruar qasje të barabartë dhe adekuate në shërbime publike

Për këtë qëllim ZKKK (Koordinatori dhe Zyrtari(ët) (e) për kthim të qëndrueshëm) do të -

- Arrij deri të refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerit vullnetarisht dhe personat e riatdhesuar, të lehtësojnë dialogun në mes komuniteteve për kthim

dhe pranim. Kjo përfshinë dhe lehtësimin e 'shko dhe informo' dhe 'shko dhe shiko vizitat'.

- Vlerësimi i nevojave specifike për personat aktual dhe potencial në kthim vullnetar ose të riatdhesuar në komunë, Duke përfshirë nevojat specifike të grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Kjo përfshinë kërkesat për regjistrim për kthim dhe mbajtjen e një bazë të të dhënave për kthim në koordinim me Ministrin për Komunitete dhe Kthim.
- Mbanë lidhje me komunat dhe institucionet qendrore qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në çështjet e kthimit dhe ri-integrimit.
- Plani dhe lehtësimi i punës në organizimin e Grupit Punues Komunal për Kthim (GPK) dhe Task Forca Komunale për kthim. Kjo duhet të përfshijë duke siguruar që përfaqësuesit legjitim për refugjat dhe persona të zhvendosur dhe akterët relevant rregullisht të marrin pjesë.
- Të sigurohet që GPK-ja zhvillon, kërkon fonde dhe mbikëqyr implementimin e Strategjisë Komunale për Kthim dhe promovimin e projekteve specifike për krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim në komunë. Strategjitë dhe Projektet do të zhvillohen në koordinim me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, do të jenë subjekt për miratim nga kryetari i komunës dhe asambleja komunal.
- Nxitja e vetëdijes dhe shpërndarja e informacionit mbi të drejtat e refugjateve, personat e zhvendosur brenda, të kthyerit vullnetarisht dhe personat e zhvendosur.
- Këshillon Kryetarin dhe ekzekutivin dhe degët përfaqësuese të komunës në lidhje me detyrimet komunale për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e refugjateve, personave të zhvendosur dhe personave të kthyer vullnetarisht ose që janë riatdhesuar në komunë.
- Monitoron dhe raporton për mbrojtjen dhe promovimin e drejtave të refugjatëve, personave të zhvendosur, personave të kthyer vullnetarisht dhe personave të riatdhesuar nga autoritetet qendrore dhe ato komunale të cilat ofrojnë shërbime publike në nivelin komunal. Kjo përfshin monitorimin dhe implementimin e projekteve për kthim dhe ri-integrim.
- Siguruar dhe promovuar qasjen në shëndetësi, arsim dhe shërbime tjera të rëndësishme për të kthyerit dhe personat e zhvendosur brenda vendit PZHBV , personat e riatdhesuar.
- Mbledh informacione për PZHBV që është zhvendosur brenda komunës përkatëse dhe identifikon nevojat për zgjidhje të qëndrueshme.
- Monitoron menaxhimin e kushteve të jetesës në strehimore kolektive (nëse ekzistojnë në komunat përkatëse)

Regjistron të gjithë të kthyerit dhe regjistron të dhënat e tyre në bazën e të dhënave, drejtpërdrejt ose nëpërmjet MKK-së ose UNHCR-it.

2. Palët e interesuara dhe partnerët

*Kush janë palët e interesuara të përfshira në zbatimin e këtyre Termave të Referencës **TeR** (institucionet qendrore dhe ato komunale, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të) dhe cilat janë lidhjet mes tyre*

Në fushën e kthimit të qëndrueshëm ZKKK-ja (Kryetari, Koordinatori dhe Zyrtari(ët) (e) për kthim të qëndrueshëm) do të bashkëpunojnë në një spektër të gjerë me institucione dhe organizata, duke përfshirë -

- **Institucionet Komunale:** Drejtorit të ekzekutivit, Asambleja Komunal dhe Komitetet e saj, institucionet dhe kompanitë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike (duke përfshirë shkollat, qendrat shëndetësore familjare dhe spitalet, Qendra për Punë Sociale, Zyra Rajonale e Punësimit, shërbimet publike etj); çështjet e komunitetit dhe institucioneve për kthim (Grupi Punues Komunal për Kthim(GPK) dhe Task Forcat (TF), Nënkryetari për komunitete, Zëvendës kryetari i kuvendit të komunës për komunitete, Komiteti i komuniteteve në Kuvendin Komunal; Këshilli i Komuniteti Komunale për Siguri)
- **Institucionet në nivel qendror:** Institucionet qeveritare (ministrit e linjës) – Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Administratës Publike (MAP), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Policia e Kosovës (PK); Njësia për Koordinim dhe Kthim në Zyrën e Kryeministrit (NJKK); Zyra e Kryeministrit për Çështje të komuniteteve; Kuvendi i Kosovës dhe Komisioni i tij për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për Kthim (KDIK); Këshilli Konsultativ i Komuniteteve (KKK) në Zyrën e Presidentit të Kosovës.
- **Komunat dhe autoritetet në territorin e së cilës refugjatet, personat e zhvendosur dhe personat e mundshëm të riatdhesuar janë zhvendosur ose qëndrojnë:** në koordinim me institucionet e nivelit qendror.
- **Organizatat Ndërkombëtare** të përfshira por jo të kufizuara si: UNHCR, ECLC, UNDP, OSBE, ICO, DRC, Caritas
- **Shoqëritë Lokale Civile dhe organizatat jo- qeveritare (OJQ),** përfshirë por jo të kufizuara në: organizatat që përfaqësojnë refugjatet, personat e zhvendosur, personat e riatdhesuar, që pranojnë komunitete dhe komunitetet jo-shumicë.

3. Aktivitetet/Procedurat

3.1. Zhvillimi dhe mbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë përfituese (kush?, çfarë?, si?)

Koordinatori dhe Zyrtari(ët)(e) për kthim të qëndrueshëm, në koordinim me MKK, UNHCR-in dhe me partneret tjerë implementues, dhe me GPK-ën dhe TFs do të bëjë -

- Vizita të rregullta në terren dhe të arrijë tek refugjatët, personave të zhvendosur, personave të riatdhesuar dhe komuniteteve pritëse në vende të kthimit, dhe proceset e ri-integrimit janë planifikuar, pritët ose kanë zënë vend tani.
- Organizimi dhe sigurimi për kryerje të suksesshme të-
 - 'Shko dhe informo vizitat (ku ZKKK arrin tek refugjatet dhe personat e zhvendosur në vendin e zhvendosjes së tyre dhe i informon ata për situatën në vendin e tyre të origjinës, procedurat dhe projektet që u mundësojnë kthimin e tyre nëse dëshirojnë; dhe
 - 'Shko dhe shiko vizitat, ' ku grupet e refugjatëve ose personat e zhvendosur janë ndihmuar të bëjnë një vizite pronës së tyre dhe vendit e tyre të origjinës në komunë, ky kontakt është mundësuar nga autoritete komunale, komunitetet pritëse dhe organizatat tjera vendore dhe ndërkombëtare që mund të lehtësojnë / mbështesin projekte për kthimin e tyre, nëse ata dëshirojnë
- Lehtësimi i dialogut ndër- etnik, integrimi i komuniteteve dhe ndërtimi besimit ndërmjet komuniteteve me mbështetjen e zyrtareve në nivel- qendror dhe komunal, përfaqësuesit e komuniteteve shumicë dhe jo- shumicë, refugjatët dhe personat e zhvendosur.
- Informon refugjatët, personat e zhvendosur (dhe komunitetet pritëse) lidhur me drejtat e tyre dhe procedurat e mekanizmave në lidhje me procesin e kthimit të qëndrueshëm .

3.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara (kush?, çfarë?, si?)

Shefi i ZKKK-se dhe Zyrtari(ët)i (e) për kthim të qëndrueshëm do të siguroj bashkëpunim me institucionet në nivel qendror , duke pasur parasysh mandatet e tyre përkatëse (të përshkruara si me poshtë)

- MKK-ja zhvillon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave për kthim të qëndrueshëm dhe komunitete jo-shumicë. MKK-ja, në bashkëpunim me donatoret, dhe fondet e projekteve specifike për kthim dhe ri-integrim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur (përfshin rindërtimin e shtëpive, dialogun ndër-etnik, grandet për krijimin dhe gjenerimin e të ardhurave dhe ndihmave tjera sipas nevojës). ZKKK-ja do të promovoj implementimin e kthimit të MKK-ës dhe politikat e ri-integrimit në komunë dhe të koordinoj bashkëpunimin e autoriteteve komunale me MKK-në
- MAPL-ja mbikëqyr zbatimin e politikave për vetëqeverisje lokale komunale dhe zbatimin e kompetencave Komunale në përputhje me ligjin mbi vetëqeverisjen lokale dhe legjislacionet e tjera mbi autoritetet komunale. Ju ndihmon komunave në zbatimin e kompetencave të tyre dhe kështu duke ju siguruar shërbime thelbësore për ri-integrimin e personave të kthyer ose të riatdhesuar në komunë.

ZKKK-ja duhet të koordinoj dhe të informoj MAPL-në mbi ofrimin e shërbimeve publike komunale për komunitetin jo shumicë, refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e riatdhesuar.

- MAP-ja e mbikëqyrë zbatimin e politikave të shërbimit civil dhe ofrimin e shërbimeve civile në nivelin qendror dhe komunal. Komuna është përgjegjëse të zbatoj politika të tilla, në lidhje me shërbimet e saja civile. Politika të tilla, përfshijnë prezantime të drejta dhe proporcionale të komunitetit jo-shumicë në shërbimet civile të administratës qendrore dhe komunale. ZKKK-ja duhet të ndihmojë autoritetet komunale në zbatimin e obligimeve të tyre në lidhje me reprezentimin e drejt dhe proporcional të komuniteteve jo-shumicë në shërbimet civile komunale duke përfshirë, të kthyerit, personat e riatdhesuar dhe personat e zhvendosur në Komunë.
- MPMS e mbikëqyrë zbatimin e politikave për punësim dhe mirëqenie sociale. Komuna (Drejtoria për mirëqenie sociale dhe Qendra për punë sociale) është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të mirëqenies sociale. Zyra rajonale për Punësim nën autoritetin e MPMS-ës regjistron dhe siguron trajnime për punë-kërkuesit dhe promovon kushte për punësim në nivelin komunal. MPMS-ja (në bashkëpunim me MPB) koordinon procedurat për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në Komunë. ZKKK-ja duhet të bashkëpunoj me Drejtorinë për Mirëqenie Sociale, Qendrën për Punë sociale dhe Zyrën Rajonale për Punësim për të siguruar që të kthyerit vullnetarisht dhe personat e riatdhesuar të kenë qasje adekuate në shërbimet e mirëqenies social dhe raste dhe mundësi punësimi. MKK-ja duhet të koordinoj implementimin e procedurave (MPMS-MPB) për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në nivel komunal. MSH-ja e mbikëqyrë sigurimin e shërbimeve primare (Qendrat për Mjekësi Familjare) dhe kujdesit mjekësor sekondar (Spitaleve); Drejtoria Komunale për Shëndetësi është drejtpërdrejt përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve primare shëndetësore (qendrat e mjekësisë familjare) në komunë. ZKKK-ja duhet të këshilloj institucionet e mjekësisë primare dhe sekondare në lidhje me sigurimin e shërbimeve adekuate mjekësore për të kthyerit aktual dhe të kthyerit të mundshëm dhe personat e riatdhesuar, duke përfshirë ata që i takojnë komunitetit jo-shumicë dhe grupeve të tjera të ndjeshme.
- MASHT-i i cakton politikat dhe standardet për ofrimin e arsimimit të detyruar (para-shkollor, fillor dhe të mesëm) dhe arsimimit të lartë (universitetit). Komuna (Drejtoria Komunale Për Arsim) është përgjegjëse të menaxhojë sigurimin e arsimimit para-shkollor, fillor dhe të mesëm (duke përfshirë Objektet adekuate arsimore-shkollat, çerdhet dhe kopshtet) – si dhe të siguroj arsimimin në gjuhët e komuniteteve jo-shumicë. ZKKK-ja duhet ta këshilloj Drejtorinë Komunale për Arsim në lidhje me qasjen e të kthyerve aktual dhe atyre të mundshëm dhe personave të riatdhesuar në arsimim, duke përfshirë edhe arsimimin në gjuhët e jo-shumicë.
- MPB-ja e mbikëqyrë ofrimin e regjistrimit civil dhe shërbimet e gjendjes civile përmes regjistrimit civil komunal të saj (sigurimin e dokumenteve personale)

dhe gjendjes civile (regjistrimin e fakteve themelore të lindjes, martesës dhe vdekjes dhe sigurimi i certifikatave të ngjashme. ZKKK-ja duhet ta lehtësoj qasjen e komuniteteve jo-shumicë, të kthyerve dhe personave të riatdhesuar me dokumente personale dhe me regjistrim në gjendjen civile. MPB-ja (në bashkëpunim me MPMS-në) koordinon procedurat për ri-pranimin dhe për ri-integrim të personave të riatdhesuar. ZKKK-ja duhet të koordinoj implementimin e procedurave të tilla në nivelin komunal.

- Policia e Kosovës (PK) Siguron zbatimin e ligjit, ndalimin e krimit dhe sigurinë publike në komunë. Ajo arrin tek komuniteti jo-shumicë dhe të rikthyerit përmes njësive të policisë në komunitet dhe këshillohet me komunitetet dhe me autoritet komunal në lidhje me sigurinë e komunitetit dhe parandalimin e krimit përmes Këshillave Komunal për Siguri. PK është një agjenci themelore për garantimin e sigurisë së lëvizjes për komunitetin e pambrojtura jo-shumicë dhe personave të kthyer pas zhvendosjes. ZKKK-ja duhet të marr pjesë në Këshillin Komunal për Sigurinë e Komuniteteve dhe të bashkëpunoj ngushtë me PK në çështjet që ndikojnë në sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së komuniteteve jo shumicë, refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar. Në veçanti ZKKK-ja duhet të punoj në Koordinim dhe bashkëpunim më të ngushtë me Njësit e Policisë në Komunitete në secilën komunë.

Si pjesë e bashkëpunimit me përfaqësuesit e ekzekutivit dhe institucionet për kthim dhe komunitete të komunës -

- Kryetari i ZKKK-së duhet të merr pjesë në secilin takim të Drejtorëve Komunal.
- Kryetari i ZKKK-së duhet të merr pjesë në secilin takim të Komitetit të Komuniteteve
- Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i për kthim të qëndrueshëm duhet, në baza mujore, të organizojë Grupin Punues Komunal për Kthim.
- Sipas nevojës Zyra do të organizoj nën-grupe punuese dhe takime të Task Forcës për të trajtuar çështje të veçanta lidhur me kthimin.

Nëse shihet e përshtatshme Kryetari i ZKKK-së ose Koordinatori për Kthim të Qëndrueshëm do ta këshilloj Kryetarin e Komunës që të themeloj format e marrëveshjeve për bashkëpunim ndër-komunal me qëllim të promovimit të një kthimi të qëndrueshëm dhe ri-integrimin të refugjatëve dhe personave të zhvendosur

3.3. Vlerësimi i nevojave të përfituesve '(kush? çfarë? se si?)

Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i(e)për Kthim të qëndrueshëm në koordinim me institucionet komunale , GPK, TF, MKK, UNHCR-ën dhe partner të tjerë institucional dhe OJQ-të lokale do të vlerësojnë nevojat e përfituesve (refugjatëve dhe personave të zhvendosur) të cilët kanë parashtruar kërkesa për ndihmë në kthim dhe ri-integrim.

Vlerësimi i nevojave do të bazohet në hapat vijues:

1. **Vlerësimi para kthimit** : vizitë të drejtpërdrejt tek aplikuesi (të kthyerit potencial) në vendet e zhvendosjes, informacione nga organizata ndërkombëtare, pjesëmarrje në vizitat “shko-shiko” dhe “shko-informohu” etj. Takime të TF etj.
2. **Vlerësimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm**: Verifikimi i strehimit dhe gjendjes së pronave në komunën e origjinës në vendin e zhvendosjes, vlerësim i situatës (siguria, liria e lëvizjes, mundësia e punësimit dhe gjenerimit të të ardhurave, qasjes dhe barazi në shkollim, në kujdes mjekësor, mirëqenie sociale, shërbimeve publike, infrastrukturë bazë dhe shërbime të tjera bazë) në komunën e origjinës apo për ndonjë zhvendosje të propozuar, vlerësim i nevojave për ndihmë sociale, dhe ndihmën e pranuar paraprakisht për kthim etj.
3. **Vlerësimi, Referimi dhe ofrimi i ndihmës pas kthimit**: ndërtimi ose rindërtimi (Shtëpi të kategorisë V ose VI) artikujt shtëpiak bazë (mobileje dhe teknik e bardhë) grande për gjenerimin e të ardhurave (të ardhurat e gjeneruar) paketa të ushqimeve, higjienës, dru (sipas nevojës) këtu përfshihet edhe ndihma në dispozicion në nivel komunal. Kualiteti dhe përshtatshmëria e asistencës së siguruar do të vlerësohet në bazë të kriterit të dhënë.
4. Përcjellja e vazhdueshme për ri-integrim pas kthimit: veçanërisht me referim për të siguruar qasje të barabartë dhe të qëndrueshme në shërbimet adekuate. Kjo do të përfshijë një vlerësim të vazhdueshëm në lidhje me ri-integrimin e të kthyerve. Vëmendje e veçantë duhet ti kushtohet vlerësimit nëse shërbimet publike të siguruar nga komuna dhe ofruesit e tjerë të jenë të arritshme në mënyrë të barabartë për refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e riatdhesuar dhe në mënyrë adekuate të ju përgjigjen nevojave të tyre. Në veçanti ZKKK-ja do të vlerësojë dhe të ofroj rekomandime për të siguruar që këto shërbime të jenë: Jo diskriminuese (të ofruara pa diskriminim), fizikisht të arritshme, të përbalueshme dhe të arritshme për informacionin. Qasja në informacione duhet të përfshijë që informatat mbi shërbimet relevante të jenë në dispozicion në gjuhën zyrtare dhe në gjuhët në përdorim të komunës dhe kur është e mundur dhe kur kërkohet në gjuhë të tjera jo-shumicë të të kthyerve

3.4. Zhvillimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi (Kush? Çka? Si?)

- Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i(e) për kthim të qëndrueshëm duhet të sigurohen që GPK, duhet të kenë parasysh që politikën për kthim dhe ri-integrim të krijuar më herët nga MKK-ja , dhe në konsultim me Kryetarin e Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive Komunale të zhvillojnë një Strategji Komunale Vjetore për Kthim në përputhje me strategjitë dhe politikën e zhvilluar në nivel qendror, të financuar nga buxheti komunal dhe burimet tjera.
- Shefi i ZKKK-se-së do të dorëzojë Strategjinë Komunale për kthim për aprovim në Kuvendin Komunal.

- Pas miratimit dhe buxhetimit të Strategjisë Komunale për Kthim, Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i(e) për Kthim të Qëndrueshëm duhet të siguroj Zbatimin e tij përmes GPK.
- GPK përmes TF-ës shqyrton kërkesat për ndihmë në kthim dhe miraton listën përfundimtare të përfituesve dhe harton Projekte të veçanta për kthim.
- GPK-ja dërgon listën e përfituesve të propozuar dhe projektin për asistencën në kthim tek Komiteti Drejtues i MKK-ës për aprovim
- Pas miratimit të MKK-ës, Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i(e) për Kthim të Qëndrueshëm Bashkëveprojnë me Institucionet kompetente të komunës për të mundësuar zbatimin e projektit për kthim. Varësisht nga natyra e parashikuar mbi Asistencën për kthim kjo mund të përfshijë:
 - Verifikim të pronësisë dhe përgatitje dokumenteve teknike për ndërtim dhe rindërtim nga kadastra komunale;
 - Sigurimi i lejeve të nevojshme për ndërtim;
 - Procedurat për regjistrim civil lëshimi i dokumenteve personale dhe certifikatave mbi statusin civil nga Zyra Komunale për status Civil dhe Regjistrim Civil;
 - Vlerësimi i së drejtës për ndihmë sociale nga departamenti komunal i mirëqenies sociale dhe Qendrës për Punë Sociale;
 - Hapat e Drejtorive Komunale të shëndetësisë dhe arsimit për të mundësuar regjistrimin e të kthyerve dhe qasjen e tyre në kujdesin shëndetësor dhe shërbimet e arsimit nën përgjegjësin e tyre;
 - Regjistrimi i të kthyerve me moshë pune në Zyrën Rajonale Për Punësim dhe ofrimin e shërbimeve të trajnimit dhe Punë-kërkimit
 - ZKKK-ja(Koordinatori dhe Zyrtari(ët)(e) për Kthim të qëndrueshëm) përcjellin dhe monitorojnë i zbatimin e projekteve të aprovuara (duke ju siguruar komente për MKK- në dhe donatorët)

3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivel komunal (Kush? Çka? Si?)

Siç është e mandatuara nga Rregullorja e Qeverisë 02/2010, ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari(ët)(e) për Kthim të qëndrueshëm) është përgjegjëse të monitoroj implementimin e politikave qendrore për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të refugjatëve dhe personave të zhvendosur nga autoritetet komunale.

Një model raportimi i dizajnuar nga MKK-ja është i bashkangjitur me këto Terma të Referencës

Shefi i ZKKK-se-ës duhet të siguroj instruksione dhe drejtimin e më tejshëm mbi procedurat e monitorimit tek Koordinatori dhe Zyrtari(ët)(e) për Kthim të qëndrueshëm.

Nën drejtimin e Koordinatorit, Zyrtarit(ve) për kthim të qëndrueshëm do të :

- Monitoroj dhe vlerësoj ndikimin e politikave komunale, vendimet dhe përvojat mbi: krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm; ri-integrimi i të kthyerve

vullnetar dhe të personave të riatdhesuar pas kthimit të tyre; qasjen e tyre të barabartë në shërbime publike.

- Krijimi i mekanizmave përmes të cilave të kthyerit, personat e riatdhesuar dhe personat e zhvendosur në komunë mund të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin e ndikimit të politikave komunale dhe praktikave në ri-integrimin e tyre

Vlerësim/monitorimi i gjetjeve në raportin e ZKKK -ës do të bazohen në

- Reagimet nga të kthyerit, personat e riatdhesuar dhe personat e zhvendosur në komunë
- Diskutimet dhe koordinimi me institucionet komunale dhe akterëve të tjerë
- Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve duke u fokusuar në zbatimin e politikave komunale dhe ndikim e tyre në të drejtat dhe ri-integrimin e të kthyerve, personave të riatdhesuar dhe personave të zhvendosur në komunë

3.6. Ofrimi i këshillave për organet komunale ekzekutive dhe përfaqësuese (Kush? Çka? si?)

Për tu siguruar që praktikatat dhe politikatat komunale të jenë në përputhje me të drejtat e refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar dhe me krijimin e kushteve për kthimin e tyre të qëndrueshëm dhe ri-integrimin e tyre, siç është këshilluar nga Koordinatori dhe Zyrtar(ve) për Kthim të qëndrueshëm, Shefi i ZKKK-se-ës do të-

- Këshillon, në koordinim me të kthyerit e tjerë dhe Institucionet komunal për çështje të komuniteteve, Institucionet komunale në lidhje me krijimin e kushteve për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrimin e të kthyerve në mënyrë vullnetare dhe personave të riatdhesuar në komunë.
- Informon në këshillon refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerit dhe personat të riatdhesuar në komunë/ projektet dhe përcjellja e nevojave të tyre, pikëpamjet dhe rekomandimet për Institucionet komunale.
- Formulimi dhe diskutimi i rekomandimeve me Kryetarin e Komunës, Asamblenë Komunale dhe Komitetet e saj si dhe Drejtoritë Komunale
- Të propozojë veprime imediate tek institucionet përkatëse në rast të shkeljeve

Rekomandimet e ZKKK-s do të jenë të bazuara në konsultime të rregullta me refugjatët dhe personat e zhvendosur, të kthyerit dhe personat e riatdhesuar, si dhe vlerësimi i nevojave të tyre, situatës dhe mundësisë që të gëzojnë të drejta të veçanta të krijuara nga Koordinatori, Zyrtar(ve) për kthim të qëndrueshëm .

3.7. Raportimi (Kush? Çka? Si?)

Brenda ZKKK-s, Zyrtari (ët) tek Koordinatori për Kthim të Qëndrueshëm raporton (jë) në baza javore. Koordinatori i raporton Kryetarit të ZKKK-së.

Shefi i ZKKK-se-s do ti dorëzoj raporte Kryetarit të Komunës, Asamblesë Komunale dhe Komiteteve të saj në baza mujore, dy herë në vit dhe në baza vjetore.

Raportet do të jenë në lidhje : Përformancën e ZKKK-s, situatën e refugjatëve, personave të zhvendosur, të kthyerve vullnetar dhe personave të riatdhesuar si dhe implementimin e politikave për kthimin e tyre të qëndrueshëm dhe ri-integrimit nga komuna dhe raporte tjera të jashtme që janë ndarë me persona të lartë cekur përmes përfaqësuesve dhe kanaleve të krijuara tani dhe në të ardhmen.

Raportet gjashtë mujore dhe vjetore gjithashtu duhet të publikohen dhe shpërndahen për refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerve vullnetar dhe personave të zhvendosur për komentim nga ana e tyre. Komentet e marra nga këto grupe dhe publiku i përgjithshëm do të përfshihet në raportet e ardhshme.

Një model raportimi i dizajnuar nga MKK-ja është i bashkangjitur me këto Terma të Referencës.

Një kopje e raportit të ZKKK-s do ti dërgohet institucioneve relevante qendrore përfshirë edhe MKK-ës, MAPL-ës, Njësia e Kryeministrit për Koordinim dhe Mbështetje të Kthimit, Zyra e Kryeministrit për çështje të Komuniteteve dhe Këshillit Konsultativ për Komunitete

3.8. Vetëdijesimi Publik (Kush? Çka? Si?)

Brenda ZKKK-s, Koordinatorin dhe Zyrtarin(ët) për Kthim të qëndrueshëm në koordinim me departamentet e relevante komunale, do të organizoj(në) kampanja publike për informim dhe të përgatit dhe të siguroj shpërndarjen e materialeve informuese dhe raporteve mbi :

- Punën dhe arritjet e ZKKK-s
- Politikën e zbatueshme dhe procedurat për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim dhe mbi të drejtat e refugjatëve ,personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar
- Informata mbi integrimin e të kthyerve dhe të personave të riatdhesuar në komunë, situatën e individëve që mbeten të zhvendosur jashtë komunës, projektet për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim të zbatuar nga komuna (përfshirë organizimin e vizitave në vendet e prejardhjes ose të zhvendosjes, rindërtimi dhe projektet infrastrukturore, krijimin dhe gjenerimi i të ardhurave dhe mundësive për punësim etj

Organizimi i kampanjave dhe materialit informues do të jenë në shënjestër në mënyre specifike dhe do të shpërndahen te: refugjatët, personat e zhvendosur, personat e riatdhesuar, komuniteti shumicë edhe jo-shumicë

Kampanja do të organizohet dhe materiali informues do të shpërndahet në gjuhën e komunitetit shumicë dhe jo-shumicë dhe do të përdoren media lokale, përfshirë edhe shtypin, radion, TV, si dhe faqen e internetit të komunës.

3.9. Planifikimi dhe Buxhetimi i Zyrës (Kush? Çka? Si?)

Koordinatori dhe Zyrtari(ve) për Kthim të qëndrueshëm duhet të ndihmoj Kryetarin E ZKKK-s që të siguroj-

- Zhvillimin e buxhetit vjetor të ZKKK-s (me referim të veçanet financimin e zbatimit të Strategjisë Komonale për Kthim dhe projekteve për të ndihmuar kthimin dhe ri-integrimin e refugjatëve ,personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar)
- Zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë komunale për kthim (Vjetore)
- Implementimin e politikave dhe strategjive ekzistuese në nivel qendror
- Përgatitja e një plani për çdo vit pune ; dhe
- Përgatitja e planeve punuese individuale

Shefi i ZKKK-se-së do të

- Propozoj një buxhet vjetor për ZKKK-ën tek Kryetari i Komunës
- Të sigurohet që buxheti i propozuar nga ZKKK-ja të mundësoj personel të duhur dhe funksionim të zyrës si dhe financim adekuat të projekteve dhe aktiviteteve që janë nën kompetencat e tyre.

Kryetari i Komunës do të sigurojë që:

- Buxheti i komunës përfshin një artikull të veçantë mbi ZKKK-ën që tregon numrin e personelit, dhe burimeve financiare të caktuar për ZKKK-ën për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shpenzime për shërbime, subvencionet dhe transferet, dhe shpenzimet kapitale.
- Buxheti i ZKKK-së siguron financim dhe burime logjistike adekuate për zbatimin e Rregullores së Qeverisë 02/2010 mbi ZKKK-në
- Buxheti i ZKKK-së duhet të jetë në përputhje me buxhetin e saktë dhe kufirin për stafin e përcaktuar nga MEF-s qarkoren mbi buxhetin.

3.10. Mirëmbajtja e bazës të të dhënave të përfitueseve (kush ? çfarë? si?)

MKK-ja,MPB-ja MPMS-ja do të-

- Do të zhvilloj një Bazë të të dhënave për të kthyerit të dizajnuar në mënyrë të veçantë për çështjet të lidhura me kthimin dhe ri-integrimin e refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar
- Të trajnoj stafin e ZKKK-së për operimin dhe ruajtjen e të të dhënave në data bazë

Komponenti i kthimit të bazës të të dhënave do të zhvillohet dhe do të menaxhohet nga MKK-ja në Koordinim me UNHCR-në

Në koordinim me MKK-në, MPB-në dhe MPMS-në dhe nën mbikëqyrjen e Koordinatorit, Zyrtarit(ve) për Kthim Të Qëndrueshëm do të

- Përgatis Pyetësorë, të bëjë intervista individuale, vlerësime dhe anketa në lidhje me refugjatët, personave të zhvendosur dhe të kthyerve për qëllim të bazës të të dhënave për kthim dhe riatdhesim
- Rregullisht të vendos dhe të freskoj informacionet mbi refugjatët, personat e zhvendosur dhe personat e riatdhesuar në Bazën e të dhënave të ZKKK-se mbi të kthyerit dhe të riatdhesuari
- Të sigurohet që baza e të dhënave e ZKKK-së dhe informatat e mbledhura dhe të përpunuara të ju nënshtrohen pëlqimit personal të individëve të cilëve ju përkasin këto të dhëna dhe në pajtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

Shefi i ZKKK-se-së paraqet raporte të rregullta statistikore për akterët përkatës. Këto raporte duhet të përfshijnë informacione mbi refugjatët, personat e zhvendosur, të kthyerit vullnetarisht personave të riatdhesuar dhe nevojat e grupeve të tilla

IV. Riatdhesimi

1. Sfondi

Cilat probleme/çështje/ nevoja që u përgjigjet zyra për

Riatdhesim ndodh kur një person e humb ose nuk ka bazë ligjore për të qëndruar në një vend të huaj dhe duhet të kthehet në vendin e tij origjinës. Personi nuk ka bazë ligjore për të qëndruar në një vend të huaj nëse viza e tij ka skaduar dhe nuk është ripërtërë, dhe kërkesa për azil i refuzohet ,nëse ai ose ajo ka hyr në vend në mënyrë ilegale, dhe në qoftë se leja e qëndrimit i anulohet.

Ri-pranimi dhe ri-integrimi i personave të riatdhesuar është prioritet i qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe është një kërkesë thelbësore në pjesën e procesit për liberalizimin e vizave. Republika e Kosovës ka nënshkruar marrëveshje të ri-pranimit me disa vende evropiane, në cilat, gjatë dekadave të fundit, mijëra persona me origjinë nga Kosova kanë migruar, kanë kërkuar azil dhe janë vendosur me vendqëndrim. Si pjesë e këtyre marrëveshje të ri-pranimit, një numër i konsiderueshëm i personave me origjinë nga Kosova janë ri-pranuar apo pritët të pranohen në vitet që vijnë. Ata janë fëmijët, të moshuarit, nënat, baballarët, burrat dhe gratë nga të gjitha komunitetet. Pas kthimit të tyre, ata kanë nevojë të veçanta urgjente, duke filluar nga qasje në regjistrimin civil, dokumentet personale, strehimi, kthimi i pronave ose rindërtimi, duke kërkuar punësim, kujdes shëndetësor, shërbime të mirëqenies sociale dhe regjistrimit në sistemin arsimor (që është veçanërisht e vështirë për fëmijët që kanë lindur jashtë vendit dhe nuk e flasin gjuhën Shqipe, Serbe apo ndo një gjuhë tjetër të komuniteteve që mësohen në sistemin arsimor të Kosovës).

Përveç Ligjit për Ri-pranim, politikat e përcaktuara nga qeveria në fushën e ri-pranimit dhe ri-integrimit përfshinë -

- Strategjinë për ri-integrimin e personave të riatdhesuar;
- Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë;
- Prioritetet në ri-integrimin e personave të riatdhesuar (përgjegjësitë e komunave), 4 prill 2011;

Qeveria ka themeluar një Bord Ekzekutiv për zbatimin e politikës për ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Bordi Ekzekutiv kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) dhe është i përbërë edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR)). Bordi

është përkrahur nga Sekretariati dhe është përkrahur nga Zyra e ri-integrimit e vendosura në ambientet e MPB.

Fondi qendror (Programi për Riatdhesim) për ri-integrimin e personave të ri-pranuar (3,500,000 Euro në 2011) është themeluar nga Qeveria për të ndihmuar komunat në ofrimin e shërbimeve të domosdoshme për personat e ri-pranuar. Komunat, nëpërmjet ZKKK do të paraqesin projektet për financim nga Fondi qendror. Udhërrëfyeni për ri-integrim është përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme që të udhëzoj personat e ri-pranuar që përmes shërbimeve që kanë në dispozicion të sigurojnë ri-integrimin e tyre. ZKKK do të jetë e familjarizuar me këtë, duke informuar personat e ri-pranuar në përmbajtjen e saj, dhe i udhëzon ata që të kenë qasje në shërbimet përkatëse

Komunat, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e nivelit qendror do të kenë rolin kryesor në sigurimin e personave të riatdhesuar se a janë ri-integruar në mënyrë efektive pas kthimit të tyre, veçanërisht në fushat kryesore të tilla siç janë regjistrimi civil, strehimi dhe të drejtat pronësore, arsimimi, kujdesi shëndetësor, shërbimet sociale dhe punësimi.. Në nivel komunal, ZKKK-ja do të ndihmojë zbatimin e politikave qendrore në ri-pranimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar.

Në këtë detyrë ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari (ve) për kthim të qëndrueshëm, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të ZKKK-së) do të -

- Koordinim të ngushtë me MAPL-në, MPMS-në dhe MSH pikat e kontaktit në aeroport për të siguruar mbledhjen e informatave para arritjes (përfshirë strehimin, arsimimin, kujdesin shëndetësor dhe nevojat tjera) personat e riatdhesuar të paraparë të kthehen në komunë, për të ju mundësuar autoriteteve komunale të organizojnë shërbime adekuate për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.
- Të jetë pika e parë e kontaktit për personat e ri-pranuar në nivelin komunal dhe të sigurojë pritjen e tyre dhe regjistrimin gjatë arritjes (pas transportit në vendin e origjinës, dhe si kusht për të ofruar ndihmë). Regjistrimi duhet të bëhet nëpërmjet një formulari standard për regjistrim të përgatitur nga Bordi Ekzekutiv.
- Lehtësimi i ofrimit të shërbimeve që kërkohen prej drejtorive kompetente komunale, administratat dhe shërbimet publike, të përfshira por je të limituara për -
 - *Regjistrimi Civil* (trajtimi i personave të riatdhesuar në Zyrat e Komunës së Gjendje Civile dhe Qendra Komunale e Regjistrimit Civil)
 - *Kujdesi Shëndetësor* (trajtimi i personave të riatdhesuar në Drejtorinë Komunale për Shëndetësi dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Spitalet)
 - *Arsimimi* (në bashkëpunim me Drejtoritë Komunale të Arsimit dhe aktivitetet në Drejtoritë e Shkollave në lidhje me regjistrimin dhe integrimin e nxënësve të ri-pranuar në arsimin e Kosovës - përfshirë, kurë është e nevojshme me ane të kurseve për gjuhë.
 - *Punësimi* (koordinimin me qendrën rajonale të punësimit ose të zyrës komunale të punësimit, për të lehtësuar ofrimin e shërbimeve përkatëse)

- *Mirëqenia Sociale* (në bashkëpunim me zyrën komunale për ndarje të pensioneve dhe përfitimeve, Qendra për punë sociale, në lidhje me ndihmën sociale, pensionet, ndihma materiale për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara)
- *Strehimi Social dhe prona* (në bashkëpunim me zyrat rajonale të Agjencisë Kosovare të Pronës - KPA-së, Zyra Kadastrale Komunale, Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale, si të rëndësishme, janë relevante.)
- Përgatit ose asiston në përgatitjen e projekte propozimeve për dorëzimin dhe financimin nga Fondi Qendror për Ri-integrimin e Personave të Ri-pranuar.
- Identifikon, promovon, implementon dhe monitoron aktivitetet e programeve të synuara në mënyrë të veçantë në përmirësimin e shërbimeve dhe krijimin e kushteve për personat e ri-integruar dhe të ri-pranuar.
- Duke u siguruar që politikat qeveritare dhe legjislacioni për ri-integrimin e personave të riatdhesuar janë zbatuar në mënyrë vazhdueshme.
- Të japin informacione për personat e riatdhesuar për të drejta e tyre dhe ndihmën që kanë në dispozicion, përkatësisht, udhëheq nevojat e personave të riatdhesuar në zyrat tjera kompetente të administratës.
- Të mbajë një bazë të të dhënave për personat e riatdhesuar, duke përfshirë të dhënat personale dhe nevojat e veçanta të personave të riatdhesuar

2. Palët e interesuara dhe partnerët

Kush janë palët e interesuara të përfshira në zbatimin e këtyre Termave të Referencës TeR (institucionet qendrore dhe ato komunale, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të) dhe cilat janë lidhjet mes tyre

Në nivel komunal:

- Institucionet Komunale: Kryetari, Zëvendës Kryetari, Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete, Asambleja Komunale, përfshirë Komitetin për Komunitete, Zyrtarët Komunal për Integritime Evropiane, Drejtoria Komunale e Shëndetësisë, Drejtoria komunale e Arsimit, Drejtoria komunale për Mirëqenie Sociale, Qendra për Punë Sociale, Zyra Komunale për ndarje të pensioneve dhe përfitimeve, Qendra Komunale e Regjistrimit Civil dhe Zyra Komunale për Gjendje Civile, Këshilli Komunal për Siguri të Komunitete, qendrat rajonale dhe komunale të punësimit dhe qendrat e aftësisimit profesional duke përfshirë edhe institucione tjera si shkollat, qendrat shëndetësore familjare, spitalet, zyrat rajonale të Agjencisë Kosovare të Pronës
- **Palët tjera të interesuara:** Organizatat ndërkombëtare dhe OJQ-të që veprojnë në komunë që kanë të bëjnë me riatdhesimin dhe riintegrimin, komunitetet e biznesit.

Në nivel qendror:

- *Linja ekzekutive:* Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Bordi Ekzekutiv (për zbatimin e Politikave të Ri-pranimit dhe Ri-integrimit) - i përbërë nga ministritë kyçe siç janë MPB, MAPL, MMPH, MPMS, MSH, MASHT as dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) Komisionari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR). Bordi Ekzekutiv do të mbrojë / miratojë projektet e paraqitura nga komunat (ZKKK-) për financim nga Fondi Qendror për ri-integrimin e personave të ri-pranuar.

3. Aktivitetet/Procedurat

3.1. Zhvillimi dhe mbajtja e kontakteve me të gjitha kategoritë përfituese (kush?, çfarë?, si?)

ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari/ve për kthim të qëndrueshëm), në bashkëpunim të ngushtë me institucionet relevante të nivelit qendror dhe palët tjera të interesuara, duke përfshirë shoqërinë civile do të -

- Mban lidhje me drejtoritë përkatëse komunale, në mënyrë që tu referohen personave të riatdhesuar shërbimet përkatëse të ofruara nga autoritetet lokale dhe për të siguruar ri-integrim të qëndrueshëm të tyre, duke përfshirë fushat kyçe të shëndetësisë, arsimit, punësisimit, kujdesit social dhe banimit;
- Mban lidhje me kryetarin e komunës në mënyrë që të siguroj buxhet të mjaftueshëm për zbatim efikas të politikave, projekteve dhe aktiviteteve në fushat e ri-integrimit të personave të riatdhesuar.
- Përmes Ministrisë për Qeverisje Lokale, mbajnë kontakte me Ministritë tjera të Qeverisë siç janë MPB-ja dhe MPMS-ja për të siguruar informacione me kohë mbi numrin e personave të riatdhesuar dhe nevojat e tyre;
- Organizon vizita në teren për vlerësimin e kushteve dhe nevojave tek personat e riatdhesuar pas kthimit të tyre;
- Mbajtja e një bazë të të dhënave për personat e riatdhesuar, duke përfshirë të dhënat personale bazë dhe nevojat e veçanta të personave të riatdhesuar;
- Nxitja proaktive e vetëdijes për të drejtat e personave të riatdhesuar., lehtësimi i qasjes në shërbimet publike, dhe zhvillim, zbatimin dhe monitorimin e projekteve dhe aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave të kthyer ose duke i riatdhesuar ata në komunë;
- Organizimi i vizitave të rregullta në terren, iniciativat për dialog, informimin e personave të riatdhesuar rreth të drejtave dhe ndihmave që ka në dispozicion.

3.2. Koordinimi dhe bashkëpunimi me palët e interesuara (kush?, çfarë?, si?)

ZKKK-ja (Kryetari i Zyrës dhe Koordinatori/ Zyrtari/(ve) për kthim të qëndrueshëm) do të ofrojë bashkëpunim të mëtutjeshëm me institucione e nivelit qendror duke marrë parasysht mandatet e tyre përkatëse –

- **Bordi Ekzekutiv** për zbatimin e politikave dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar, gjithashtu është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave komunale për mbështetjen e Fondit Qendror për personat e riatdhesuar.
- **Sekretariati i Bordit Ekzekutiv.**
- **Zyra e Ri-integrimit,** e vendosur në ambientet e MPB-së.
- **Fondi i Qeverisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar.** Për zbatimin e përgjithshëm të kësaj politike QeK ka identifikuar dhe aprovuar një buxhet vjetor përafërsisht 3,5 milionë euro. Ky fond është miratuar tashmë nga Kuvendi i Kosovës dhe është në dispozicion për të gjitha institucionet përkatëse për të bërë kërkesës për financim e projekteve të tyre që janë të lidhura me ri-integrimin e personave të riatdhesuar. Të gjitha detajet mbi procedurat dhe formularët mund të merren nëpërmjet kontaktit me MPB-në zyrës për ri-integrim ose duke e vizituar ueb faqen e MPB-së <http://www.mpb-ks.org/> dhe pastaj duke klikuar në linkun e ri-pranimit
- **MPB-ja,** është përgjegjëse për të koordinuar zbatimin e të gjitha politikave për ri-integrimin e personave të ri-pranuar, gjithashtu është përgjegjëse edhe për koordinimin e statusit komunal civil dhe shërbimet e regjistrimit civil.
- **MAPL-ja,** është përgjegjëse për të koordinuar rrjedhjen e informacioneve në mes komunave të (ZKKK-së) dhe Bordit Ekzekutiv.
- **MLSW,** është përgjegjëse (ekipet e aeroportit) për pritjen, regjistrimin, transportimin e personave që nuk kanë mjete të transportit deri tek vendi i origjinës, si dhe strehim të përkohshëm (deri në një javë) të personave të ri-pranuar; përgjigjët për mirëqenien sociale dhe politikat e punës që kanë të bëjnë me personat e ri-pranuar.
- **MSH,** është përgjegjëse për shqyrtimin fillestar (ekipet mjekësore të aeroportit) nevojave mjekësore për personat e ri-pranuar dhe është përgjegjëse për koordinimin e shërbimeve primare dhe sekondare mjekësore.
- **MASHT.** Ka nxjerr një udhëzim administrativ për regjistrimin e fëmijëve të riatdhesuar dhe do të ndihmoj komunat në organizimin e gjuhëve dhe orëve shtesë që çon në ri-integrimin arsimor të fëmijëve të ri-pranuar.
- **MMPH,** është përgjegjëse për bashkëpunim me autoritetet komunale për çështje që lidhen me planifikimin hapësinor, duke përfshirë strehimin.
- **Agjencia Kosovare e Pronës (AKP)** është përgjegjëse për demet e riposedimit të pronës, administrimin e pronave të lira që mund të përdoren, për strehimin e personave të riatdhesuar, riposedimit në pritje nga ana e pronareve të ligjshëm.

ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari(ët) për kthim të qëndrueshëm), gjithashtu do të kryej aktivitetet e me poshtme të koordinimit -

- Harta e organizatave lokale dhe ndërkombëtare dhe OJQ-ve që punojnë në riatdhesim dhe ri-integrim;
- Mban kontakte të rregullta me MAPL-në në lidhje me çështjet që lidhen me riatdhesimin dhe ri-integrimin dhe kërkojnë vëmendje nga niveli qendror;
- Koordinim me drejtoritë përkatëse komunale, institucionet dhe ofruesit e shërbimeve publike në lidhje me çështjet e lidhura me ri-integrimin e personave të riatdhesuar: referimi për regjistrim civil (Zyra Komunale për Gjendje Civile dhe Qendra Komunale për Regjistrim Civil), qasje në kujdesin shëndetësor (Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Spitalet Rajonale), qasja në arsim (Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Drejtorët e Shkollave, mundësit për punësim ()), skemat e mirëqenies sociale social (Qendra për punë sociale, zyra komunale nga ndarjet të pensioneve dhe përfitimeve), strehimi social dhe prona (AKP-ja, Zyra Kadastrale Komunale, Drejtoria Komunale për Mirëqenie Sociale).

3.3. Vlerësimi i nevojave të përfituesve '(kush? çfarë? se si?)

ZKKK-ja (Koordinatori dhe Zyrtari(ët)i / ve për Kthim të Qëndrueshëm) do të -

- Të bëjë vlerësimin e nevojave të personave të riatdhesuar në komunën përkatëse.
- Të bëjë vizita në terren dhe të nxis ndërgjegjësimin për të drejtat e personave të riatdhesuar.
- Të përgatis projekt-propozime për personat e riatdhesuar, në nevojë për ndihmë, nga fondi për ri-integrim (siç përcaktohet në kriterin për përfitime në fondin për ri-integrim, dhe në varësi nga vendimi i Bordit Ekzekutiv qendror);
- Përcjellje/monitorim i vazhdueshëm i riatdhesimit dhe raportimi mbi progresin dhe sfidat.

3.4. Zhvillimi i projektit, monitorimi dhe vlerësimi (Kush? Çka? Si?)

Pasi personi i riatdhesuar të transportohet në Komunë, ZKKK-ja (Koordinatori /Zyrtari(ët)i për Kthim të Qëndrueshëm) do të -

- 1) **Regjistrojnë personat e ri-pranuar** përmes formularit të ri-pranimit fillestar (nëse i njëjti nuk e ka mbushur në Zyrën e aeroportit). Regjistrimi është parakusht për ofrimin e ndihmës dhe do të përfshijë --
 - A. **Të dhënat dhe verifikimi** (në koordinim me personat kompetentët për ofrimin e shërbimeve publike dhe institucionet komunale) **i të dhënave në lidhje me përshtatshmërinë e personit për ndihmë**, si dhe në nevojat e veçanta për ri-integrim të aplikuesit, do të përfshijë -

- i. Nëse aplikuesi ka dokumente personale që dëshmojnë se ai apo ajo është një person i riatdhesuar (Dokumente Udhëtimi të Lëshuara për një Udhëtim të Vetëm)
- ii. Nëse personi i riatdhesuar është një banor i mëhershëm i asaj komune,
- iii. Ku ka jetuar aplikuesi para se ta lëshoj Kosovën,
- iv. Nëse aplikuesi ka vendbanim (Shtëpi apo apartament) ose prona tjera në komunë në përputhje me të dhënat përkatëse kadastrale
- v. Kontrollim i dyfishuar që aplikanti nuk ka përfituar nga ndihma e kërkuar në komunat tjera ose me ndonjë emër tjetër (Duhet ta kontrolloni me OJQ-të dhe me institucione e tjera që operojnë në komunën tuaj)

B. Posedimi i certifikatave dhe dokumenteve personale që mundëson qasjen në shërbimet esenciale publike. Në këtë drejtim ZKKK-ja duhet të verifikoj nëse aplikanti i posedon apo duhet ti marrë

- i. Certifikatën e lindjes (veçanërisht nëse personi ka lindur jashtë) ,
- ii. Certifikatën e martesës,
- iii. Pasaportën e Kosovës,
- iv. Letërnjoftimin e Kosovës,
- v. Dokumentet Transitore të UNMIK-ut, dhe/ose letërnjoftimin e UNMIK-ut,
- vi. Certifikatën mjekësore,
- vii. Certifikatat shkollore (sidomos për nxënësit e moshës shkollore sigurohuni që ata të kenë certifikatat e shkollës dhe diplomat)
- viii. Dokumente lidhur me punësimin dhe pensionimin dt,
- ix. Dokumentet e pronësisë
- x. Etj.

2) Përgatitja dhe aplikimi për Fondin qendror për ri-integrimin e personave të ri-pranuar (Programi i Riatdhesimit), të sigurohet që aplikanti të merr ndihmën adekuate. Parimet e Përgjithshme: sa më shumë të dhëna që mund mbledh ZKKK-ja si pjesë e regjistrimit të aplikantit (numër 1), ka më shumë gjasa që aplikacioni i dorëzuar në emër të aplikantit të aprovet nga Fondi qendror-

Aplikacioni duhet gjithmonë -

- Të dorëzohet nga ZKKK-ja e komunës përkatëse, me logon e komunës dhe në formën e një kërkesë zyrtare, e nënshkruar dhe e vulosur nga zyrtari përkatës i ZKKK-së
- Të dorëzohet sa më parë që të jetë e mundshme, pas plotësimit të dokumentacioneve dhe kriterëve të shënuara më poshtë.
- Referohuni tek kriteret e përzgjedhjes që kushtëzon qasjen në programin për ri-integrimin e personave të riatdhesuar.
- Përshkruani të gjitha nevojat specifike që i japin aplikantit të drejtën e bazuar në kriterin e përzgjedhjeve nga Fondi.
- Përmban një përshkrim të plot të artikujve për të cilët është kërkuar ndihma dhe tregon pikërisht shumën financiare të ndihmës se kërkuar për secilin artikull ndarazi

dhe totalin e tyre.

- 3) **Rishikimi i aplikacionit.** Sekretariati i Bordit Ekzekutiv (BE) do të vlerësoj kërkesën për asistencë dhe projekte të dorëzuara nga ZKKK-ja dhe i dërgojnë ato te BE me rekomandime. BE do të marr vendimin përfundimtarë. Pas vendimit të BE, Zyrtari për riatdhesim i MPB duhet të njoftoj ZKKK-n dhe komunën në lidhje me aprovimin apo refuzimin e kërkesës.
 -
- 4) **Kërkesa për rishikim dhe ankesat administrative.** Në rast se një kërkesë për ndihmë është refuzuar dhe ZKKK-ja ose aplikuesi konsideron që aplikacioni ka qen i refuzuar në mënyrë të pa drejt, ZKKK-ja ose aplikuesi mund të dorëzojë një kërkesë për rishikim tek BE ose një ankesë administrative kundër vendimit të BE, Në pajtueshmëri me legjislacionin e aplikueshëm mbi procedurat administrative
- 5) **Shpërndarja e fondeve pas aprovimit të kërkesës** Të gjitha procedurat për zbatimin e fondeve pas miratimit nga BE duhet të bëhen nga Departamenti i Buxhetit dhe Financave dhe Departamenti për Prokurim Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Përveç procedurave të lart cekura të aplikimit ZKKK-ja (Koordinatori dhe zyrtari/ët për kthim të qëndrueshëm) do të jenë të angazhuar për të ndërmarrë këto

- Konsultohen me Kryetarin, Asamblenë Komunale dhe Komitet e saj mbi zgjedhjen e projekteve primare për ri-integrimin e personave të riatdhesuar;
- Marrin pjesë në përgatitjen e buxhetit komunal dhe i dorëzojnë te Kryetari dhe Drejtori i Financave dhe Ekonomisë propozimet e projektet primare që synojnë ri-integrimin e personave të riatdhesuar;
- Raportim të rregullt te Kryetari, Asambleja Komunale, dhe nëse kërkohet, te institucionet e nivelit qendror, mbi zbatimin e projekteve për ri-integrimin e personave të riatdhesuar ..
- Organizojnë këshillime publike në zona ku personat e riatdhesuar kthehen, për të identifikuar projektet primare që synojnë komunitetet pritëse dhe personat e ri-pranuar për tu përfshirë në buxhetin e komunës.
- Të sigurohen që secili projekt të synoj të arrij qëllime të konkrete, të matshme dhe të arritshme, që rreziqet të identifikohen në mënyrë të duhur, si dhe qëllimet të jenë në përputhje me planin punues të ZKKK-së dhe me nevojat e komuniteteve;
- Monitoron dhe vlerëson zbatimin e projekteve që synojnë ri-integrimin e personave të riatdhesuar drejt këtyre objektivave, të përshtatet plani i zbatimit nëse është e nevojshme
- Siguron mundësitë që personat e ri-pranuar të marrin pjesë në monitorimin, vlerësimin dhe ndikimin e projekteve që i etiketojnë ata si përfitues
- Bazuar në vlerësimin e projekteve, identifikimin e përvojave të mira, mësimëve të mësuara dhe zhvillimin e projekteve përkatëse;

- Ruajtja e vetëdijesimit të donatorëve ekzistues dhe thirrja për propozime të hapura për komunat
- Ruajtja e vetëdijesimit të iniciativave nga OJQ-të lokale dhe zhvillimi i qasjeve të përbashkëta
- Bazuar në prioritete, zhvillon projekt-propozime dhe i dorëzon ato tek institucionet relevante dhe donatorët
- Rregullisht koordinon me akterët e tjerë (Institucionet e nivelit qendror, organizatat ndërkombëtare) mbi aktivitetet dhe projektet në Komunë

3.5. Monitorimi dhe zbatimi i politikave në nivel komunal (Kush? Çka? Si?)

ZKKK-ja (*Koordinatori dhe Zyrtari/ët për kthim të qëndrueshëm*) është përgjegjës për të vlerësuar zbatimin e Planit dhe Strategjisë për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe politikave të tjera të rëndësishme për personat e riatdhesuar

Nën udhëheqjen e Koordinatorit, zyrtarit/ve për kthim të qëndrueshëm do të

- Monitoron dhe vlerëson ri-integrimin e personave të riatdhesuar si dhe qasjen e tyre në regjistrimin civil, punësim dhe aftësim profesional, në shërbimet shëndetësore, mirëqenie sociale, arsimim, banim dhe atë pronësor;
- Monitoron dhe vlerëson projektet që etiketojnë individët dhe familjet e mbështetura nga fondi për ri-integrim;
- Monitoron dhe vlerësojnë ndikimin e politikave komunale, vendimeve dhe praktikave mbi kushtet për pranimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar

Monitorimi dhe vlerësimi duhet të bazohet në: reagimet nga personat e riatdhesuar, vizita në terren/kontaktime, diskutime/takime me institucione relevante komunale, diskutime/kontaktime me institucionet relevante qendrore koordinim i rregullt/bashkëveprim me palët e interesuara.

3.6. Ofrimi i këshillave për organet komunale ekzekutive dhe përfaqësuese (kush? çka? si?)

Në ZKKK, Zyrtari(ët) do të këshillojnë Koordinatorin për Kthim të Qëndrueshëm, ndërsa Koordinatori për Kthim të Qëndrueshëm do të këshillojë Kryetarin e ZKKK-së mbi zbatimin e politikave dhe projekteve për ri-integrimin e personave të riatdhesuar

ZKKK-ja (Shefi i Zyrës, Koordinatori ose Zyrtari(ët) për Kthim të Qëndrueshëm, në raste të rëndësishme dhe të nevojshme) do të -

- Ofrojnë këshilla institucioneve relevante komunale dhe qendrore mbi politikat, strategjitë dhe programet/projektet me qëllim të lehtësimit dhe kthimit të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar
- Këshillon personat e riatdhesuar për të drejtat e tyre, obligimet, mundësitë dhe shërbimet lidhur me ri-integrimin e tyre
- Këshillon dhe koordinon me palët e tjera në lidhje me politikat e afrimit dhe praktikave për ri-integrimin e personave të riatdhesuar

3.7. Raportimi (Kush? Çka? Si?)

Brenda ZKKK-së, Zyrtari(ët)i për Kthim të Qëndrueshëm raporton, në baza javore, tek Koordinatori . Koordinatori raporton tek Shefi i Zyrës.

Kryetari i ZKKK-së do ti dorëzoj raportin Kryetarit të Komunës, Asamblesë Komunale dhe komiteteve të saj, në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore në lidhje me përfundimin e zyrës dhe situatën e personave të riatdhesuar dhe kthimit të tyre të qëndrueshëm

Një format i raportimit i dizajnuar nga Ministri për Komunitete dhe Kthim është i bashkangjitur me këto Terma të Referencës

Një kopje e raporteve të ZKKK-së do ti dërgohet institucioneve relevante qendrore, përfshirë Ministrin për Komunitete dhe Kthim, Ministrin e Administrimit dhe Qeverisjes Lokale, Ministrin e Punëve të brendshme, Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrin e Arsimit, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria për Integritim Evropian.

Raporti Ad-hoc mund të kërkohet nga Bordi Ekzekutiv për Ri-integrim përmes MAPL-së dhe Kryetarit të Komunës lidhur me rezultatet e arritura me Ri-integrimin e personave të Riatdhesuar.

3.8. Vetëdijesimi Publik (Kush? Çka? Si?)

Brenda ZKKK-së, Koordinatorin dhe Zyrtari/ët për Kthim të Qëndrueshëm do të organizojnë fushata të vetëdijesimit publik për të informuar personat e riatdhesuar mbi politika dhe ligjet e lidhura me lehtësimin dhe qasjen në shërbime publike të ofruara nga komuna dhe ministritë.

Kampanja do të bëhet duke përdorur media lokale, përfshi shtypin, radion dhe TV, si dhe faqen e interneti të komunës. Kampanja do të siguroj kontaktime me personat e riatdhesuar.

3.9. Planifikimi dhe Buxhetimi i Zyrës (Kush? Çka? Si?)

ZKKK-ja (Shefi i zyrës për kthim të qëndrueshëm) do të siguroj që planifikimi buxhetor i komunës i adreson nevojat e personave të riatdhesuar, kjo do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë zyrtarët komunal që e bëjnë planifikimin e buxhetit komunal.

Koordinatori dhe Zyrtari/ët për Kthim të Qëndrueshëm duhet të ndihmoj Shefin e Zyrës për të siguruar-

- Paraqitja e aplikacioneve dhe projekteve për financim tek Fondi qendror për ripranim të personave të riatdhesuar, përmes Sekretariatit të Bordit Ekzekutiv për ri-integrim
- Zhvillimi i një buxheti vjetor të ZKKK-së (me referim veçantë mbi nevojat dhe projektet e personave të riatdhesuar);
- Zhvillimi dhe zbatimi i një strategjie 3 vjeçare nga ZKKK-ja
- Përgatitja e planit vjetor; dhe
- Përgatitja e planit punues individual

3.10. Mirëmbajtja e bazës të të dhënave të përfitueseve (kush ? çfarë? si?)

-Ministria e Punëve të Brendshme do të -

- Zhvillon një bazë të të dhënave në të cilën ZKKK-ja përfshin të dhënat mbi personat e riatdhesuar nën kujdesin e tyre;
- Trajnimi i stafit të ZKKK-së në funksionimin e bazës të të dhënave dhe mbrojtjen e dhënave.

Nën mbikëqyrjen e Koordinatorit, Zyrtarit (ve) për kthim të qëndrueshëm do të -

- Ofrojë të dhëna për bazën e të të dhënave të menaxhuar nga MPB-ja në baza të rregullta mujore me anë të një sistemi të raportimit;
- Sigurojë që informacionet e Bazës të të dhënave të ZKKK-së mblidhen dhe përpunohen si lëndë për miratim personal të individëve të cilit iu perkasin të dhënat personale në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.

Anekset

1. Rregullorja e Qeverisë nr 02/2010 për Zyrrat Komunale për Komunitete dhe Kthim
2. Vendimi MKK-ja për krijimin e Grupit Punues për ZKKK-në Përshkrimet i Punës dhe Termit e Referencës
3. Përshkrimi i Detyrave të punës për ZKKK-në
4. Format i Raportimit
5. Diagrami në linjat e raportimit të ZKKK-së dhe përgjegjësit
6. Diagrami i ZKKK-së në partneritetin e nivelit qendror dhe komunal
7. Diagrami për ZKKK-në Organizimi i brendshëm dhe marrëdhëniet ndërmjet funksioneve të ZKKK-së

8. Definicioni , politikat dhe legjislacioni përkatës për punën e ZKKK-Së

8.1 Të Drejtat e Komuniteteve dhe qasja në shërbime

- a) Definicioni
- b) Abstraktet për dispozitat kushtetuese në lidhje me punën e ZKKK-së
- c) Lista e legjislacionit përkatës për të Drejtat e Komunitetit dhe integrimi

8.2 Kthimi

- a) Definicioni
- b) Lista e legjislacionit dhe dokumentet politike përkatëse për të drejtat e refugjateve, personave të zhvendosur dhe procedurat për kthim të qëndrueshëm dhe ri-integrim

8.3 Riatdhesimi

- a) Definicioni (shih udhërrëfyesin për ri-integrim, dokument i veçantë)
- b) Definicioni (shih broshurën për Zyrrarët komunal mbi pranimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar, dukument i veçantë)
- c) Prioritetet në ri-integrimin e personave të riatdhesuar (përgjegjësit e komunave) 4 prill 2011
- d) Legjislacioni dhe politikat e zbatueshme për ri-pranimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar